



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**Psh. Nr. 111/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Vedat Poterqoi-Anëtare, Kimete Gashi, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Erdogan Pirqi B.I." kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve" Nr prokurimi VU644-22-9414-2-2-1 iniciuar nga Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK) më 05.04.2023 mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet** ankesa e operatorit ekonomik "Erdogan Pirqi B.I." me seli në Vushtëri, e ushtruar me 24.02.2023 (Nr. Protokolli 111/23) kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve" me nr prokurimi VU644-22-9414-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e AK, kurse Vendimi i datës 07.02.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit, **Vërtetohet**.

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës për ankesë e operatorit ekonomik OE "Erdogan Pirqi B.I.", kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

**A r s y e t i m**

**- Faktet dhe rrethanat procedurale -**

Komuna e Vushtrrisë nga cilësia e saj si AK, me 07.02.2023, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve" me nr. prokurimi VU644-22-9414-2-2-1, me ç' rast elementet qenësore të prokurimit janë precizuar si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbime, kurse vlera e parashikuar e kontratës 60,000,00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 15.09.2022, data e hapjes së ofertës 05.10.2022 kurse Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 07.02.2023.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave -*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 10.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar;  
Mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 07.02.2023(*njoftimi për dhëne të kontratës*)

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Ankuesi ne parashtresën e tij drejtuar Oshp me datwn 24.02.2023, pretendon se Ak pa të drejtë e kishte eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit lidhur me validitetin e ofertës së tij (*përshkruar në detaje në ankesën nr protokolli 111/23*)<sup>1</sup> duke vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,28,59,69, dhe 72 të LPP.

Eksperti shqyrtues lidhur me këto pretendime sqaron se AK kishte kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave nga Ankuesi konform Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, mirëpo, ankuesi nuk e kishte vazhduar validitetin dhe mos vazhdimi i validitetit sipas LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, respektivisht nenit 30 pika 6 në të cilën citohet "*Është e hapur për secilën OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të vendosin të mos zgjasin validitetin e tyre do të refuzohet si të "papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre*" e bënë të papërgjegjshëm. Andaj përgjigjja e Ankuesit lidhur me këtë arsye të eliminimit të tij, se në momentin kur AK ju kishte kërkuar zgjatjen e validitetit me datë 26.01.2023 kishte qenë jashtë vendit, ky argument nuk është cilësuar si i qëndrueshëm nga Eksperti shqyrtues meqenëse ankuesi nëpërmes postës

<sup>1</sup> [https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?\\_\\_RequestVerificationToken](https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?__RequestVerificationToken)

elektronike ka mundur të përgjigjet apo ta ngarkoj në e-prokurim deklarimin për zgjatje të validitetit, kështu mos plotësimi i kërkesave administrative vërtetojnë faktin se i njëjti nuk mund të konsiderohet palë me interes pasi nuk ka mundur të dëshmojë me fakte/dëshmi që i plotëson dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit.

Në këtë rast, Paneli Shqyrtues mbështet arsyetimin e dhënë nga eksperti shqyrtues dhe po ashtu konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast. Lidhur me këtë, duhet theksuar se në paragrafin 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, përkufizohet shprehimisht statusi i palës së interesuar, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të *dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit*, i zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose *mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*. Paragrafi i cituar, do të thotë se Ankuesi duhet të *dëshmojë interes material*, thënë me saktë interesin e tij material dhe të dëshmojë njëherësh faktin, nëse është *dëmtuar nga një shkelje e pretenduar*. Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim për hirë të së vërtetës materiale dhe gjykimit objektiv në këtë rast edhe dispozitat si në vijim:

- Në nenin 103, të LPP, thuhet: “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

- Po ashtu, në nenin 111, të LPP parashihet se çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë, kurse OSHP do të marrë masa nëse ankesa e tillë vërteton se parashtruesi kualifikohet si *palë e interesuar siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji*” (shih: paragrafi 1.5). dhe se “...shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë *dëme materiale parashtruesit të ankesës..*” (shih paragrafi 1.8.).

Mbetet përgjegjësi e AK zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit e deri tek nënshkrimi i kontratës njëherit obligohet që ti zbatojë në përpikmëri dispozitat e nenit 27,28, 60, 65,66,68 dhe 69 të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111, të LPP ngase i njëjti nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm mbi bazën e të lartëcekurave e në kuptim të nenit 30 pika 6 rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Vjosa Gradinaj Mexhuani

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale- Dhoma e shkallës së parë, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- KK Komuna Vushtrrisë
- 1x1 OE "Erdogan Pirqi B.I.", me seli në Vushtri
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.